

SKEDË INFORMUESE

Mundësi për aplikim të Bashkive në thirrjen Canada Fund for Local Initiatives - Albania 2026

Synimi i Thirrjes:

CFLI është një program që mbështet projekte të vogla, por me ndikim të lartë në vendet në zhvillim. Projektet duhet të jenë të lidhura me prioritetet tematike të Global Affairs Canada, në fushat ku Kanadaja kërkon të mbështesë zhvillimin, demokracinë, qeverisjen dhe përfshirjen sociale. Pra, nuk do të financohen projekte shumë të mëdha infrastrukturore ose programe shumëvjeçare, por projekte konkrete, lokale, të realizueshme brenda afatit, me rezultate të matshme dhe me ndikim të qartë te komuniteti.

Prioritetet tematike për 2026:

Çdo projekt duhet të përputhet me të paktën një nga këto prioritete:

- Qeverisje gjithëpërfshirëse, duke përfshirë diversitetin, demokracinë, të drejtat e njeriut, të drejtat 2SLGBTQI+ dhe sundimin e ligjit.
- Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave.
- Paqja dhe siguria, me fokus në parandalimin e konflikteve dhe ndërtimin e paqes.
- Rritja që u sjell dobi të gjithëve, siç janë të drejtat ekonomike të grave, vendet e lira të punës dhe sipërmarrja, investimi në më të prekshmit dhe mbrojtja e progresit ekonomik.
- Veprimi mjedisor dhe klimatik, duke u përqendruar në përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike, si dhe menaxhimi i ujërave.
- Dinjiteti njerëzor, që mbulon shëndetin, arsimimin dhe ushqyerjen.

Kush mund të aplikojë?

Përfitues të pranueshëm janë:

- OJQ lokale, organizata komunitare dhe jofitimprurëse,
- institucione akademike lokale,
- organizata ndërkombëtare që punojnë me partnerë lokalë,
- Autoritete vendore dhe rajonale/ndërqeveritare, institucione shtetërore dhe bashki për projekte lokale.

Kosto të pranueshme:

Lejohen kosto për paga projekti, trajnime, evente, komunikim, kërkim, përkthim, udhëtime, qira pajisjesh, website, kosto ligjore/kontabiliteti, internet, pajisje komunikimi, etj. Overhead zakonisht nuk duhet të kalojë **15%**.

Kosto të papranueshme:

Nuk financohen blerje automjetesh, mbështetje direkte fiskale për qeverinë, kosto bazë të organizatës, shpenzime para nënshkrimit të marrëveshjes, dhurata, mallra luksi, fonde rrotulluese/mikrokredi, apo ndihmë për organizata ushtarake/paramilitare.

Shuma e grantit

Kontributi mesatar është **30,000–60,000 dollarë kanadezë**. Maksimumi për një projekt është **100,000 CAD**. Fondet jepen në dollarë kanadezë dhe më pas konvertohen në monedhën lokale.

Afati i zbatimit të projektit:

Projektet duhet të përfundojnë **deri më 26 shkurt 2027**.

Si aplikohet:

Propozimet duhet të plotësohen në anglisht. Të gjitha projektet duhet të përputhen me të paktën 1 nga prioritetet tematike të mëposhtme:

- Qeverisje gjithëpërfshirëse;
- Rritje që funksionon për të gjithë.

Të gjitha projektet do të duhet të përfundojnë midis datës së nënshkrimit të Marrëveshjes së Grantit dhe 26 shkurtit 2027.

Për të marrë një formular aplikimi, ju lutemi kontaktoni adresën e email-it romeqr@international.gc.ca ose shkarkoni Formularin e Aplikimit për Financim të Projektit CFLI: <https://www.international.gc.ca/world-monde/assets/pdfs/funding-financement/cfil-fcil/3160e.pdf>

Aplikimet e plotësuara duhet të dorëzohen me email në romeqr@international.gc.ca.

Për pyetje në lidhje me procesin e aplikimit, ju lutemi kontaktoni romeqr@international.gc.ca.

Afati i aplikimit:

Aplikimet duhet të dorëzohen deri më: 21 maj 2026, ora 23:59 GMT+2.

Linku i Thirrjes: <https://www.international.gc.ca/world-monde/funding-financement/cfil-fcil/albania-albanie.aspx?lang=eng>